


NËN SPEKTRIN E PADUKSHMËRISË

Analizë mbi Dhunën me Bazë Gjinore ndaj
Komuniteteve LGBTIQ+ në Kosovë 2023-2024



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

AUTORE: LIRI KUÇI

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky raport është mbështetur nga financimi i Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Mendimet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Sida.

Përmbajtja

• Hyrja dhe Korniza Teorike	6
Çfarë është dhuna me bazë gjinore ndaj komuniteteve LGBTIQ+?	7
• Qëllimi dhe Metodologjia	8
Analiza ndërthurëse	9
• Korniza Ligjore dhe Sfidat Institucionale	10
Korniza Ligjore dhe Praktikrat e Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë	10
Shërbimet Sociale dhe Mirëqenia	13
• Gjetjet dhe Analiza	17
Format e DHBGJ ndaj Komuniteteve LGBTIQ	17
Analiza e të dhënave nga terreni	19
• Reflektime dhe Rekomandime	26
Sfidat e hulumtimit	26
Rekomandimet	27
• Shtojcë	31

Shkurtesat

LGBTIQ – individët dhe komunitetet Lesbike, Gej, Biseksuale, Transgjimore, Interseks dhe Queer

DHBGJ – Dhuna me Bazë Gjinore

CEL – Center for Equality and Liberty

ZMNV – Zyra për Mbrojtjen e Viktimave

QPS – Qendrat për Punë Sociale

CSGD – Center for Social Groups Development

MD – Ministria e Drejtësisë

QIPS – Qendra për Informim dhe Përmirësim Social

PTH – Prokuroria Themelore

GJTH – Gjykata Themelore

OSHC – Organizata të Shoqërisë Civile

QMGF – Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë

QSGF – Qendra për Sigurinë e Grave dhe Fëmijëve

Profili i autores

Liri Kuçi është hulumtuuese dhe studiuese feministe me formim në Teori Politike dhe një master të dytë në Angli, ku është thelluar në metodat e analizës së diskursit ndërsektorial dhe politikave të zhvillimit. Përgjatë një dekade, rrugëtimi i saj si aktiviste ngërthen të drejtat e njeriut, arsimin, të drejtat në punë, çështjet jedisore dhe fushat e ndërlidhura të drejtësisë sociale. Ajo është autore e studimeve, hulumtimeve, strategjive politike, dhe artikujve të ndryshëm mbi tema që përfshijnë diskursin politik, ekonominë e zhvillimit, të drejtat e grave dhe çështjet LGBTIQ+, duke kontribuar si në sferën shqipfolëse, ashtu edhe në publikime ndërkombëtare. Gjithashtu, ajo ka bashkëthemeluar “Shota.al” një revistë feministe dygjuhëshe kushtuar zbërthimit të pabarazive strukturore duke nxitur perspektiva kritike mbi sfidat e shtresëzuara shoqërore.

Hyrje

Nëpërmjet këtij hulumtimi, Qendra për Barazi dhe Liri (CEL) synon të hedhë dritë mbi praktikat institucionale në adresimin e dhunës me bazë gjinore (*referuar me akronimin DHBGJ*) ndaj individëve dhe komuniteteve LGBTIQ+ në pesë komuna në Kosovë; Prishtinë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjakovë – bazuar në mekanizmat zyrtare në proceset e parandalimit, gjurmimit dhe agazhimit për mbrojtje.

Ky raport synon të dekonstruktojë format në të cilat dhuna me bazë gjinore ndaj individëve LGBTIQ+ në Kosovë fshihet ose neglizhohet në mënyrë sistematike. Shërben si thirrje për një rishikim kritik të praktikave institucionale, përkufizimeve ligjore dhe krijimin e regjistrave gjithëpërfshirës për të dokumentuar dhe luftuar dhunën në mënyrë të ndjeshme dhe duke qendëruar përvojave të ndryshme të grupeve të marginalizuara.

Kësisoj, kjo iniciativë e CEL synon të kontribuojë në korniza më gjithëpërfshirëse të drejtësisë që sfidojnë strukturat ekzistuese të pushtetit dhe ofrojnë mbrojtje kuptimplotë për të gjithë individët, pavarësisht orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor, klasës, racës, etnisë, fesë, prejardhjes, aftësive ableiste etj.

Çfarë është dhuna me bazë gjinore ndaj komuniteteve LGBTIQ?

Një grua në Kosovë mund të përballet me dhunë jo vetëm për shkak të gjinisë së saj, por gjithashtu edhe për shkak të orientimit seksual, që ndër të tjera i sfidon pritshmëritë kulturore mbi seksualitetin apo rolet gjinore të tyre. Dhuna ndaj grave përkeqësohet kur ndërthuret me homofobinë dhe transfobinë, duke çuar në forma të dhunës me bazë gjinore që nuk adresohen nga kornizat kryesore ligjore dhe protokollet institucionale.

Kështu, dhuna ndaj individëve transgjinore/ë ndodh për t'i ndëshkuar për shkeljen e binarëve gjinorë të ndërtuar e mirëmbajtur shoqërisht. Qasja ndërthurëse i ekzaminon këto përvoja duke mos i reduktuar në një bosht të vetëm identiteti; ato janë produkt i formave të shumta dhe të mbivendosura të shtypjes.

Ky diagnostikim kompleks është i nevojshëm për zhvillimin e përgjigjeve efektive ligjore dhe institucionale që marrin parasysh kompleksitetin e përvojave të individëve LGBTIQ+ përballë dhunës.

Në Kosovë, ku normat patriarkale dominojnë dhe heteronormativiteti ngelet i rrënjësor në strukturat ligjore dhe shoqërore, dhuna e përjetuar nga individët LGBTIQ+ shpesh mbetet e panjohur ose konsiderohet si rastësi, jo si pjesë integrale e një sistemi të dhunshëm. Ky boshllëk i lë këta individë – sidomos edhe kur nënshitesëzohen brenda grupeve më të margjinalizuara, si komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane – më të ekspozuar ndaj formave të kombinuara të dhunës që shpesh mbeten të paraportuara dhe të paadresuara.

Qëllimi dhe Metodologjia

Në një vend ku kornizat socio-ligjore janë në proces evoluimi, por ende të kufizuara nga normat patriarkale dhe heteronormative, fokusi i këtij studimi nuk qëndron vetëm te dhuna, por edhe te strukturat institucionale dhe ligjore që e materializojnë, e lejojnë ose e adresojnë në mënyrë të pamjaftueshme këtë dhunë.

Duke aplikuar një perspektivë kritike ndërthurëse, metodologjia mikse në këtë studim ndërthur intervistat cilësore me pyetësorët me kampionim në bazë të pesë komunave dhe analizën e kuadrit ligjor, për të vlerësuar përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, ndaj individëve LGBTIQ+ në Kosovë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshin **41** entitete të kontaktuar,¹ nga të cilat u relizuan njëzetegjashtë **(26)** pyetësorë dhe intervista me aktorët kyç, të zhvilluara në periudhën maj-shtator 2024:

- Gjashtëmbëdhjetë pyetësorë **(16)** me përfaqësues/e institucionale; Ministria e Drejtësisë, oficerë/et e policisë, përfaqësuesi/et gjyqësorë, Prokuroritë Themelore, Mbrojtësit e Viktimave (ZMNV), Qendrat për Mbrojtjen e Grave (QMGF) dhe punonjësi/et sociale.
- Në proces janë përfshirë gjithashtu pesë **(5)** organizata të shoqërisë civile (OSHC);
- Pesë **(5)** intervista cilësore me aktivistë/e LGBTIQ+ dhe avokate të të drejtave të njeriut.

¹ Referoju seksionit Shtojcë fq.31

Analiza ndërthurëse

Ky studim përdor analizën ndërthurëse për të analizuar përgjigjet institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore kundër individëve LGBTIQ+ në Kosovë. Nëpërmjet kësaj perspektive shqyrtohen nënshtresat e cenueshmërisë që derivojnë nga ndërveprimi i identiteteve të ndryshme sociale duke e lokalizuar përvojën e komunitetit LGBTIQ+ brenda kornizave më të gjera të përjashtimit dhe dhunës.

Studiueset feministe dhe ndërthurëse si bell hooks (1984) theksojnë rëndësinë e njohjes së sistemeve ndërthurëse të shtypjes që e riprodhojnë dhe mirëmbajnë dhunën ndaj grupeve të marginalizuara. Në këtë kontekst, ndërthurja e gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike dhe statusit socio-ekonomik thëllon më tej cenueshmëritë që përjetojnë individët LGBTIQ+ në Kosovë.

Kjo qasje mundëson një kuptim gjithëpërfshirës në lidhje me përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore duke theksuar mangësitë sistemike në mbrojtjen e individëve të marginalizuar.

Është me rëndësi të përmendim se ky studim nuk është i vetëmjaftueshëm, porse gjen mbështetje në kontributin dhe rekomandimet ekzistuese² të dokumenteve dhe hulumtimeve të tjera nga organizatat partnere që merren me dhunën me bazë gjinore³ në Kosovë dhe në rajon.⁴

² Center for Social Group Development (CSGD), (2023) Annual Report on LGBTIQ+ Rights in Kosovo

³ Amnesty International. (2023). Kosovo: From paper to practice – Kosovo must keep its commitments to domestic violence survivors.

⁴ Reporting Diversity Network, (2024) Media Report: Monitoring Hate Speech in the Balkans.

Megjithatë, ky hulumtim ka për qëllim të çimentojë nevojën për të zgjeruar botëkuptimin e dhunës me bazë gjinore nga një perspektivë ndërthurëse, kryesisht e informuar nga përvojat dhe dhuna ndaj individëve dhe komuniteteve LGBTIQ+ në Kosovë.

Në të ardhmen është e nevojshme që raporti aktual të përditësohet me më shumë të dhëna e përfaqësi nga rajone të tjera, si dhe të pasohet nga ekzaminime periodike të thelluara dhe gjithëpërfshirëse, që përvojat e dhunës me bazë gjinore të jenë të dokumentuara me rigozitet.

Korniza Ligjore dhe Sfidat Institucionale

Analiza ndërthurëse

Ky seksion shqyrton kritikisht se si kornizat ligjore, kur shqyrtohen përmes një perspektive ndërthurëse, dështojnë t'i mbrojnë personat që përjetojnë dhunë, të cilët nuk mund të kuptohen vetëm në termat e gjinisë, por duhet të marrin parasysh edhe orientimin seksual, identitetin gjinor dhe kontekstin socio-politik të Kosovës.

Duke marrë parasysh përpjekjet e vazhdueshme të shtetit drejt integritimit evropian, ky studim merr rëndësi shtesë. Zbatimi i normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë ato që mbrojnë minoritetet, është thelbësor për legjitimitetin në arenën globale.

Megjithatë, ekzistenca e kuadrit ligjor, pavarësisht se Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje i vitit 2010 ka njohur

përmirësimet e vitit 2023⁵ për dhunën me bazë gjinore (08/L-185), dhe angazhimet e Kosovës ndaj standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën e Stambollit, nuk e zhbëjnë hendekun e thellë në mënyrën se si këto zotime përthihen për individët LGBTIQ+ realisht.

Në një analizë më të thellë dhe kontekstuale të kornizës ligjore në Kosovë mbi dhunën me bazë gjinore dhe diskriminimin ndaj grupeve të marginalizuara, veçanërisht LGBTIQ+, është e rëndësishme të shqyrtohet se si Kodi Penal i Republikës së Kosovës (06/L-074), Ligji për Barazi Gjinore (05/L-020), dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (05/L-021) përfaqësojnë një stad fillestar për të institucionalizuar përpjekjet për barazi dhe drejtësi. Për shembull, sipas diagnozës praktike të ofruar nga ekspertët ligjorë të CEL në lidhje me ligjin (05/L-021), argumentohet se aktualisht mungojnë mjetet efektive për zbatimin e tij të plotë, dhe mbetet problematike mënyra se si trajtohen ankesat e diskriminimit nga institucionet përkatëse, si gjykatat dhe organet administrative.

Kësisoj, të tri këto ligje të rëndësishme përballen me sfida dhe kufizime kur aplikohen në realitetin kompleks socio-politik të Kosovës, veçanërisht në kontekstin e ndërveprimit të shtresëzimeve të identitetit gjinor, orientimit seksual dhe pozicionimeve të tjera sociale.

Në mënyrë specifike, siç evidentohet edhe nga profesionistët ligjorë pranë CEL-it, struktura ligjore në Kosovë ka bërë disa përparime në adresimin e dhunës ndaj individëve LGBTIQ+, veçanërisht përmes ligjeve si Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfshirjes së dispozitave relevante për krimet e urrejtjes dhe përfshirjes së tyre si rrethana rënduese në Kodin Penal në nenin 70.2.12.

⁵ zëvendësuar në tetor të vitit 2023 me LIGJIN NR. 08/L-185 PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE.

Por ndonëse, Kodi Penal i Kosovës dhe Ligji për Barazi Gjinore janë të strukturuar për të ofruar mbrojtje të përgjithshme për individët, ato mbeten të limituara në përkufizimet e ngushta të dhunës dhe diskriminimit, që shpesh lidhen vetëm me seksin biologjik ose dhunën e dukshme fizike dhe kryesisht në kuadër të dhunës në familje. Ligji për Barazi Gjinore, për shembull, pavarësisht nga qëllimi i tij për të luftuar pabarazinë, mbështetet kryesisht në binarizmin gjinor dhe nuk i pranon qartë realitetet gjinore fluide ose spektrin e diversitetit që përfshin komunitetin LGBTIQ+. Ky kufizim jo vetëm që pengon njohjen e përvojave të përditshme të individëve LGBTIQ+ që përballen me diskriminim dhe dhunë, por gjithashtu forcon një qasje të ngushtë dhe esencialiste mbi identitetin gjinor dhe seksualitetin.

Megjithatë, një pengesë edhe më e rëndësishme është zbatimi praktik i ligjeve ekzistuese. Siç analizon hulumtimi i [Amnesty International](#) (2023) për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, duke theksuar mospërputhjet në zbatimin e ligjeve kundër diskriminimit nga institucionet, veçanërisht në rastet që përfshijnë DHBGJ, ku individët LGBTIQ+ shpesh injorohen, trajtohen keq dhe ritraumatizohen. Gjithashtu, këtë situatë e potencon edhe Raporti Vjetor i CSGD (2023) mbi të drejtat LGBTIQ+ në Kosovë duke dëshmuar se pavarësisht ekzistencës së mbrojtjes ligjore në letër. Përgjigja institucionale mbetet e pamjaftueshme pa ofrimin e shërbimeve për të adresuar cenueshmëritë specifike të individëve ndaj dhunës me bazë gjinore.

Kritiket feministe të ligjit, veçanërisht ato të studimeve kritike ligjore dhe teorisë ndërthurëse si Kimberlé Crenshaw (1991), argumentojnë se kuadri ligjor shpesh është bashkëpunues në forcimin e binarizmit gjinor dhe supozimeve normative që dështojnë të mbrojnë ata/o që ekzistojnë jashtë këtyre kufijve. Mangësia e terminologjisë së standardizuar, regjistrave të posaçëm sistematikë dhe praktikave në gjurmimin dhe adresimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore,

siç evidentohen edhe në këtë hulumtim, ngelen mangësitë kryesore në instancat publike. Duket se ngelen të nevojshme reforma të thella institucionale dhe shoqërore për të siguruar që dhuna me bazë gjinore ndaj individëve LGBTIQ+ të njihet dhe të adresohet efektivisht.

Siç rezulton dhe nga procesi i këtij hulumtimi, mungesa e të dhënave mbi dhunën me bazë gjinore ndaj individëve LGBTIQ+, rrjedh kryesisht nga institucionet si policia, prokuroria dhe gjykatat, të cilat dështojnë t'i klasifikojnë këto raste sipas identitetit gjinor apo orientimit seksual. Këto raste regjistrohen shpesh si "dhunë" ose "abuzim" i përgjithshëm, pa reflektuar motivet specifike që lidhen me diskriminimin ndaj komunitetit LGBTIQ+. Kjo mungesë e klasifikimit të saktë, e bazuar në përgjigjet e marra nga institucionet, thëllon padukshmërinë e problemit dhe pengon vlerësimin e vërtetë të përmasave të tij.

Për më tepër, ligjet ekzistuese shpesh nuk adresojnë realitetet e ndërlikuara të jetës së individëve LGBTIQ+, ky studim nxjerr në pah boshllëqet sistemike të trajtimit dhe adresimit të kategorive të dhunës me bazë gjinore. Në anën tjetër, kjo situatë bën edhe që institucionet të mos ofrojnë përgjigje të përshtatshme ligjore ose shërbime institucionale sipas nevojave specifike të këtyre komuniteteve, duke neglizhuar kështu mbrojtjen dhe mbështetjen e duhur.

Shërbimet Sociale dhe Mirëqenia

Një aspekt kritik i adresimit të DHBGJ ndaj individëve LGBTIQ+ është disponueshmëria e institucioneve të mirëqenies dhe shërbimeve mbështetëse.

Pyetësorët mbledhin të dhëna mbi disponueshmërinë dhe qasjen në shërbimet e mirëqenies sociale (që përfshijnë dhe kujdesin emocional, mendor dhe sigurinë fizike) duke zbuluar boshllëqe të rëndësishme në ofrimin e këtyre shërbimeve për individët LGBTIQ+.

Strehimi, rehabilitimi dhe siguria ekonomike për personat e dhunuar janë të domosdoshme për krijimin e një mjedisi mbrojtës dhe rimëkëmbës. Mirëpo, shërbimet e ofruara nga shteti shpesh përjashtojnë ose u gjenden në mënyrë të pamjaftueshme viktimave LGBTIQ+ për shkak të stigmatizimit kulturor dhe mungesës së kapaciteteve institucionale.

Sistemi i mirëqenies sociale në vend, përfshirë strehimoret për viktimat e dhunës në familje, është një tjetër arenë ku individët LGBTIQ+ përjashtohen sistematikisht. Shumë syresh veprojnë me supozimin se personat në nevojë janë gra cisgjjinore, heteroseksuale. Prandaj, në mungesë të strehimoreve të posaçme, individët LGBTIQ+ që kërkojnë strehim nga dhuna e përjetuar, u qasen strehimoreve aktuale, të cilat nuk kanë kapacitete për të akomoduar individë të tjerë.

Për shembull, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) në Prishtinë dhe Qendra për Sigurinë e Grave dhe Fëmijëve (QSGF) në Prizren raportojnë se në mungesë të strehimoreve të posaçme, individët LGBTIQ+ që kërkojnë strehim nga dhuna në familje shpesh vendosen në strehat e grave, të cilat nuk kanë as trajnimin dhe as protokollet e nevojshme për të akomoduar personat që nuk përputhen me

normat gjinore binare, prandaj dhe janë të papërgatitura potencialisht për nevojat e grave LBT dhe kryesisht individëve transgjinorë.

Megjithëse, siç vëren avokatja e të drejtave të njeriut, Edona Tolaj, ndarja e strehave në bazë të kategorizimit të identiteteve shoqërore, gjinore orientimit seksual nuk i shërben krijimit të një fryme gjithëpërfshirëse dhe barazimtare, prandaj sugjeron rritjen e kapaciteteteve dhe ndërgjegjësimin në formë paralalele nga këto institucione, që gratë LBTI të mos vijnë të segregohen edhe në hapësirat më të sigurta që siguron shoqëria, ligji dhe shteti. Përndryshe, ky përjashtim nga shërbimet kryesore e përkeqëson cënueshmërinë e individëve LGBTIQ+, duke i lënë ata/o pa mundësi sigurie ose mbështetjeje.

Teksa nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) u potencua gjithashtu se strehimoret dhe shërbimet mbrojtëse shpesh veprojnë me supozimin se viktimat e dhunës në familje janë gra heteroseksuale. Këto mangësi të paraqitura, i lënë individët LBT pa kujdes të përshtatshëm, duke i marginalizuar më tej.

Gjithashtu, mungesa e shërbimeve psikologjike të dizajnuara sipas nevojave për viktimat LGBTIQ+ të DHBGJ është një mangësi tjetër kritike në sistemin e mirëqenies sociale në Kosovë.

Dhuna psikologjike është një formë përhapur e DHBGJ që prek në mënyrë disproporcionale individët LGBTIQ+, e cila merr formën e ngacmimeve, kërcënimeve, shantazhit dhe përjashtimit shoqëror, të cilat kanë ndikime të thella në shëndetin mendor dhe mirëqenien e individëve LGBTIQ. Nga intervista me Qendrën për Informim dhe Përmirësim Sociale rezulton se DHBGJ është ndër shkatarët kryesorë të vetëvrasjeve të individëve LGBTIQ+. Gjithashtu, përfaqësuesi i QIPS Bind Skeja problematizon edhe mungesën e statistikave dhe klasifikimit të këtyre të dhënave me rëndësi madhore

mbi mirëqenien e pjesëtarë/eve të komuniteteve të margjinalizuara.

Siç raportohet nga CSGD dhe CEL-i shumë individë LGBTIQ+ përjetojnë abuzim psikologjik nga anëtarët e familjes, miqtë dhe anëtarët e komunitetit, të cilët përpiqen t'iu "korrigjojnë" orientimin seksual ose identitetin gjinor përmes manipulimit emocional, presionit psikologjik ose dhunës fizike. Kjo formë dhune nuk njihet ende si DHBGj nga institucionet, duke i lënë viktimat pa mbështetjen dhe shërbimet e nevojshme për të rimarrë veten nga trauma e tyre apo për ta adresuar dhunën siç duhet.

Ndër të tjera, ky hulumtim thekson rolin e organizatave të shoqërisë civile në mbushjen e këtyre boshllëqeve, çka shpesh vjen me burime të kufizuara dhe risqe të mëdha për punën e tyre. Procedurat standarde të veprimit ndaj dhunës në familje caktojnë QPS si përgjegjëse për ofrimin e seancave psikologjike për viktimat. Sidoqoftë, ato nuk përfshijnë udhëzime specifike për personat Queer që përjetojnë dhunë jashtë familjes, duke nxjerrë në pah boshllëqet në adresimin e këtij lloj dhune. Në këto kushte, përveç OSHC-ve si CEL dhe CSGD nuk ka shërbime shtetërore për shëndetin mendor për të trajtuar traumën e përjetuar nga viktimat LGBTIQ+ të dhunës. Kjo mungesë mbështetjeje i lë shumë viktimat pa burimet e nevojshme për të rimarrë veten nga ndikimet psikologjike të DHBGj, duke e thelluar më tej margjinalizimin e tyre.

Gjithashtu është me rëndësi të silltet në vëmendje se si faktorët ndërseksionalë, si statusi ekonomik dhe vendndodhja gjeografike i përkeqësojnë më tej sfidat me të cilat përballen individët LGBTIQ+ në qasjen ndaj shërbimeve të nevojshme, veçanërisht në zonat rurale dhe pa infrastrukturë të posaçme adresuese.

Gjetjet dhe Analiza

Format e DHBGJ ndaj Individëve LGBTIQ+

Përvojat e individëve LGBTIQ+ në Kosovë nuk janë homogjene, dhe faktorët ndërseksionalë si etnia, statusi socio-ekonomik apo vendndodhja gjeografike e formësojnë më tej cenueshmërinë e tyre ndaj DHBGJ dhe neglizhencës institucionale. Megjithatë, natyra e dhunës shpesh formësohet nga identiteti gjinor dhe orientimi seksual i viktimës. Për shembull, individët transgjinorë, veçanërisht trans-gratë, janë shpesh më të targetuara për dhunë fizike dhe seksuale për shkak të dukshmërisë së tyre dhe perceptimit të shkeljes së normave gjinore. Burrat gej dhe gratë lesbike përballen shpesh me dhunë në marrëdhëniet intime, megjithëse përvojat e tyre shpesh injorohen në diskursin ligjor dhe social, i cili kryesisht fokusohet te gratë heteroseksuale dhe cisgjinore si viktimat kryesore të DHBGJ.

Ndërsa i shtresohet identiteti gjinor edhe minoritetet etnike, Romë, Ashkali dhe Egjiptiane, aq më e ashpër bëhet dhuna, ku përballen me forma të dyfishta marginalizimi, pasi përballen me diskriminim racor, homofobi ose transfobi. Ky marginalizim i dyfishtë shpesh i lë ata/o pa asnjë mundësi për mbrojtje ligjore ose mbështetje sociale.

Gjithashtu, statusi socio-ekonomik luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e aksesit në burimet ligjore dhe institucionale. Individët LGBTIQ+ nga sfondet me të ardhura më të ulëta ka më shumë gjasa të përballen me barriera në aksesimin e drejtësisë, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve

sociale, duke përkeqësuar më tej cenueshmërinë e tyre ndaj dhunës. Pasiguria ekonomike ndërthuret me përjashtimin shoqëror, duke i lënë individët e margjinalizuar LGBTIQ+ pa mjete financiare ose kapital social për të përballuar sfidat e sistemeve ligjore dhe të mirëqenies.

Për më tepër, ndërthurja e DHBGJ me krimet e urrejtjes, homofobike dhe transfobike e ndërlikon përgjigjen ligjore dhe institucionale ndaj dhunës ndaj individëve LGBTIQ+.

Shpesh dhuna ndaj individëve LGBTIQ+ nuk njihet si një formë e dhunës me bazë gjinore ose si krim urrejtjeje dhe kategorizohet si dhunë e përgjithshme, duke i hequr kontekstin dhe implikimet specifike. Kjo mungesë njohjeje i margjinalizon më tej individët LGBTIQ+, duke i mohuar aksesin në mbrojtje ligjore dhe shërbime mbështetëse të përshtatshme.

Trajtimi i DHBGJ në Kosovë pa adresuar rastet e dhunës ndaj individëve LGBTIQ+ është tregues i qëndrimeve të përgjithshme shoqërore dhe zbulon boshllëqe të thella institucionale. Në të gjitha fazat e reagimit institucional – nga ndërhyrja e policisë, te proceset gjyqësore dhe deri te shërbimet apo punonjësi/et e mirëqenies sociale – individët LGBTIQ+ përballen vazhdimisht me pengesa për të arritur drejtësinë. Këto pengesa nuk janë vetëm produkt i stigmatizimit shoqëror, por edhe i mangësive sistemike brenda kornizave ligjore dhe të mirëqenies në Kosovë.

Hulumtimi shqyrton se si trupa institucionale të tilla i trajtojnë viktimat bazuar në identitetin e tyre gjinor dhe orientimin seksual duke çuar në atë që mund ta quajmë “padukshmëria ndërseksionale”. Ky koncept, i zhvilluar brenda teorisë feministe, i referohet mënyrave se si individët me identitete të shumta të margjinalizuara bëhen të padukshëm brenda sistemeve të krijuara për t’i shërbyer vetëm popullatës “*mainstream*”—në këtë rast, gratë heteroseksuale dhe cisgjinore, çka mund të çojë në fshirje sistematike të përvojave të LGBTIQ+ brenda përgjigjeve institucionale ndaj DHBGJ.

Trajtimi Institucional i Rasteve dhe analiza e të gjeturave nga terreni

Në një shoqëri ku mbizotërojnë strukturat heteronormative, individët LGBTIQ+ shpesh përballen jo vetëm me paragjykim, por edhe me dhunë sistematike nga ata që janë të ngarkuar me mbrojtjen e tyre. Duke analizuar këto përgjigje institucionale, ky hulumtim thekson se si paragjykimet e rrënjosura formësojnë trajtimin e viktimave LGBTIQ+, duke ndikuar si në raportimin e krimeve ashtu edhe në kërkimin e drejtësisë. Margjinalizimi i individëve LGBTIQ+ brenda kornizës së DHBGJ zbulon mungesën e mjaftueshme të kornizave ligjore ekzistuese për të adresuar cenueshmëritë e tyre specifike. Rastet e dhunës në marrëdhëniet intime midis të njëjtit seks shpesh nuk njihen si dhunë në familje, dhe krimet e urrejtjes bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor nuk trajtohen.


Ky seksion paraqet gjetjet nga intervistat, anketimet dhe analiza e dokumenteve, duke ilustruar pabarazitë në trajtimin e rasteve të DBG që përfshijnë individë LGBTIQ+ dhe pasojat e këtyre pabarazive për viktimat.

Policia është shpesh pika e parë e kontaktit për individët LGBTIQ+ që kërkojnë mbrojtje nga DHBGJ, por intervistat me zyrtarët e zbatimit të ligjit zbulojnë boshllëqe të mëdha në aftësinë e tyre për të ofruar mbështetje të përshtatshme. Shumë oficerë policie janë të papërgatitur për të trajtuar raste që përfshijnë viktimat jo-heteronormative. Si rezultat, individët LGBTIQ+, siç tregojnë përfaqësuesit e CSGD dhe CEL, shpesh raportojnë se trajtohen me indiferencë, tallje ose madje me armiqësi kur përpiqen të raportojnë dhunën.

Zyrtarët nga Prokuroria, Gjykata Themelore dhe Policia në Ferizaj, Gjakovë dhe Prizren pranuan se nuk ka një kategorizim të veçantë të rasteve të dhunës me bazë gjinore që përfshijnë individë LGBTIQ+ brenda regjistrave zyrtarë të dhunës në familje. Kjo mungesë kategorizimi jo vetëm që i bën përvojat e individëve LGBTIQ+ të padukshme brenda peizazhit institucional, por gjithashtu e bën të pamundur ndjekjen e përhapjes së dhunës ndaj këtij grupi, e cila është e nevojshme për zhvillimin efektiv të politikave dhe alokimin e burimeve.


Për shembull, **Policia e Prishtinës** raporton deri në 5 raste ndaj komunitetit LGBTIQ në periudhën 2023-2024, që përfshijnë dhunë emocionale, fizike dhe krime urrejtjeje, por pa specifika dhe klasifikime të detajuara të rasteve dhe trajtimit të tyre. **CSGD** dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (**RrGK**), **Prishtinë** kanë raportuar nga një rast të trajtimit të dhunës ndaj komuniteteve LGBTIQ duke analizuar se ngacmimet, shantazhet dhe kërcënimet për gratë lesbike apo trans, nuk marrin mbështetje të unifikuar ligjore ndërsa ushtruesve të dhunës u jepen dënime të ulëta e të pamjaftueshme për ta adresuar krimin. Sakaq nga departamenti i ndihmës ligjore në **CEL** raportohet se, në vitin 2023 kanë ofruar ndihmë për 13 raste dhe në 2024 për 7 raste.

Prishtinë – Rastet e Raportuara ndaj Komuniteteve LGBTIQ (2023 – 2024)



Ky peizazh shifrash tregon se dhuna ndaj individëve LGBTIQ+ nuk regjistrohet zyrtarisht, duke e bërë të pamundur ndjekjen e trendeve, alokimin e burimeve apo zhvillimin e ndërhyrjeve të synuara për të adresuar këtë formë specifike të dhunës.

Teksa, Prokuroria në Ferizaj ka deklaruar se ka trajtuar 223 raste të dhunës në familje në vitin 2023 dhe 139 raste në 2024, në këto shifra, kanë identifikuar vetëm një rast dhune kundër një personi nga komunitetet LGBTIQ+.



Më specifikisht, ky rast dhune nga Prokuroria Themelore në Ferizaj është verifikuar sipas PP.II.621/23 dhe trajtuar për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185. par.3, nën par. 3.2 lidhur me par. 2 të KPRK-së, ndonëse motivi ka qenë pikërisht se i dëmtuari në atë rast djali i të pandehurit i ka takuar komuniteteve LGBTIQ+.

Kështu, mungesa e protokolleve lë si opsion për oficerët të mbështeten në kornizat aktuale të pamjaftueshme për trajtimin e mëtejshëm të veprës penale shpesh herë bazuar edhe sipas e tyre personale.

Ndër të tjera, meqë nga Komuna e Ferizaj kemi arritur të nxjerrim më shumë të dhëna, nga përfaqësuesi i ZMNV Ibrahim Tërstena, rezulton se në vitin 2023 janë trajtuar 200 raste me bazë gjinore, ndërsa vetëm në periudhën Janar – Shtator në 2024 ka trajtuar 190 raste - nga të cilat asnjë person i komunitetit LGBTIQ+. Sakaq, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, (QMGF) Ferizaj – Shtëpia Ime raporton: 130 raste të trajtuara por asnjë të identifikuar prej komuniteteve LGBTIQ+.

Në këtë panoramë numrash të lartë sidomos teksa viti 2024 nuk ka përfunduar ende dhe janë tejkaluar shifrat e vitit 2023, vihet re gjithashtu edhe një diskrepancë e thellë midis dokumentimit të dhunës në familje si eksperiencë homogjene dhe dhunës me bazë gjinore ndaj individëve LGBTIQ+.

Kësisoj, në mungesë të trajnimeve ose ndjeshmërisë për të kuptuar sfidat specifike me të cilat përballen viktimat LGBTIQ+ të dhunës, si rezultat, shumë raste neglizhohen ose nuk merren fare në trajtim, siç tregon në intervistë edhe Lend Mustafa, trans-burrë dhe aktivist i komuniteteve LGBTIQ+, i cili shpesh është kthyer mbrapsh nga Prokuroria për mungesë faktesh.⁶ Pra, përveç dhunës së përjetuar, viktimave u ngarkohet edhe barra e vërtetimit, mbledhjes së të dhënave dhe dëshmive, duke e shnërruar procesin e raportimit, adresimit dhe marrjes së drejtësisë një kalvar të mundimshëm.


Pa precedentë ose udhëzime të qarta ligjore, zyrtarët gjyqësorë janë të detyruar të marrin vendime diskrecionale, të cilat shpesh dështojnë në mbrojtjen e viktimave LGBTIQ+.

Për më tepër, mungesa e të dhënave mbi rastet e DHBGJ që

⁶ Kuci, Liri. Kosovo 2.0. (2024). Tetë vjet në dritëhije. Kosovo 2.0. Retrieved from <https://kosovotwopointzero.com/en/eight-years-in-the-light-and-shadow/>

përfshijnë individë LGBTIQ+ shtrihet edhe në gjyqësor. Regjistrat gjyqësorë nuk përfshijnë kategori për orientimin seksual ose identitetin gjinor, duke e bërë të vështirë vlerësimin e shkallës së përfshirjes së individëve LGBTIQ+ nga DHBGJ ose mënyrën se si trajtohen rastet e tyre. Teksa raportohen 171 raste të dhunës në familje nga Prokuroria Themelore e Gjakovës, udhëheqësi i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media nga Gjykata në **Gjakovë**, Lekë Muqaj, problematizon se të dhënat që lidhen me përkatësinë etnike, fetare apo orientimin seksual shpesh nuk evidentohen. Si rezultat, kategorizimi dhe identifikimi i rasteve të kësaj natyre (duke iu referuar dhunës ndaj personave LGBTIQ+) mbetet i vështirë.

Siç evidenton dhe **avokatja** e të drejtave të njeriut Edona Tolaj, kjo padukshmëri brenda sistemit gjyqësor pasqyron neglizhencën më të gjerë institucionale ndaj çështjeve të LGBTIQ+ në Kosovë.



Siç vërehet në tabelën e mësipërme, nga Gjykata Themelore Pejë: Në vitin 2023 janë pranuar 140 lëndë dhe zgjidhur 74, ndërsa në vitin 2024 janë pranuar 123 dhe zgjidhur 43. Ndërsa Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve, Pejë rezultojnë 98 raste në vitin 2023 dhe 56 raste nga janari deri në shtator 2024.

Pas këtij peizazhi të zymtë e të fragmentuar në shifra e të mangët në trajtime, në këtë formë del në pah, se trajtimi gjyqësor i rasteve të DHBGJ që përfshijnë individë LGBTIQ+ zbulon paragjykime të rëndësishme brenda sistemit ligjor duke rezultuar në vendime që as nuk njohin dhe as nuk adresojnë natyrën specifike të dhunës së përjetuar nga individët LGBTIQ+.

Gjithashtu, nga pyetëtori me përfaqësues/e nga Ministria e Drejtësisë zbulohen mangësi të mëdha në klasifikimin dhe kuantifikimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, duke u konfirmuar se rastet e DHBGJ të regjistruara në regjistrat e dhunës në familje nuk kategorizohen sipas orientimit seksual ose identitetit gjinor të viktimës. Përfaqësuesit nga **MD** nuk arritën t'i jepnin përgjigje mosaksesimit të regjistrave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, duke u justifikuar për problem teknik. Teksa as tentativave disajvare të stafit të CEL për të dhëna eksplicite nuk iu dha përgjigje me shifra e kritikë për situatën aktuale, por iu devijuan me arsyetimin se se Ministria e Drejtësisë ndodhet në proces për hartimin e akteve nënligjore për përfshirjen e rasteve të dhunës me bazë gjinore në një bazë të dhënash të integruar.

Mungesa e strehimoreve LGBTIQ+: Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prizren, për shembull, pranoi se megjithëse kanë mandatin për të mbrojtur të gjitha viktimat e dhunës në familje, shërbimet e tyre nuk janë të pajisura për të përmbushur nevojat e individëve LGBTIQ+. Shumë streha

operojnë me supozimin se viktimat janë gra heteroseksuale, dhe nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për të ofruar kujdes ose siguri për gratë LBT dhe individët transgjjinorë. Nga Prizreni arritëm të përftojme vetëm këto të dhëna: Nga intervista me përfaqësues nga Gjykata Themelore Prizren theksohet nuk ka kapacitet për shqyrtimin e detajuar të rasteve të dhunës dhe pretendohet se *“Divizioni Civil ka mbi 5,000 raste të pranara në punë në tre vitet e fundit, dhe verifikimi në regjistrat në mënyrë manuale apo verifikimi i lëndëve një nga një është i pamundur, dhe tejkalon mundësitë që ka Gjykata, për të trajtuar dhe përpunuar kërkesa të tilla”* - me të tilla u referohen rasteve të DHBGJ ndaj personave LGBTIQ+. Sakaq nga QSGF Prizren raportohen deri në 100 raste të evidentuara dhe u nënvizua mungesa e strehimores për komunitetin LGBTIQ+.

Ky përjashtim nga shërbimet kyçe, i lë viktimat LGBTIQ+ të dhunës pa qasje në hapësira të sigurta, duke rritur cenueshmërinë e tyre ndaj abuzimeve të mëtejshme.

Në mungesë të mbështetjes së plotë shtetërore, organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol jetik në ofrimin e shërbimeve për individët LGBTIQ+ që përballen me dhunë me bazë gjjinore. Organizata si CSGD, CEL Kosova dhe RrGK kanë qenë thelbësore në mbushjen e boshllëqeve të lëna nga shteti, duke ofruar ndihmë ligjore, strehim emergjent, këshillim psikologjik dhe avokim. Megjithatë, siç theksohet në intervistat me to, këto organizata veprojnë me burime të kufizuara dhe përballen me sfida të mëdha për të zgjeruar shërbimet e tyre për të përmbushur nevojat e të gjithë popullatës LGBTIQ+.

Organizatat kanë qenë gjithashtu avokues kyç për reforma ligjore dhe përgjegjshmëri institucionale. Për shembull, CEL Kosova ka lobuar aktivisht për përfshirjen e mbrojtjeve për LGBTIQ+ në ligjet e dhunës në familje, si dhe për zhvillimin e legjisllacionit për krimet e urrejtjes. Pavarësisht përpjekjeve të

tyre, vullneti politik për të zbatuar këto reforma mbetet i dobët, veçanërisht përballë forcave konservatore politike dhe fetare që kundërshtojnë të drejtat e LGBTIQ+. Mbështetja e madhe të OSHC-të për ofrimin e shërbimeve thelbësore thekson dështimin e shtetit për të përmbushur detyrimet e tij sipas ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nevojën për një bashkëpunim më të madh midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile për të adresuar DHBGJ kundër individëve LGBTIQ+.

REFLEKTIME DHE REKOMANDIMET

Sfidat e hulumtimit

Ky studim ka hasur në një sërë pengesash që e kanë ndërlikuar dhe ngadalësuar analizën në lidhje me dhunën me bazë gjinore ndaj individëve LGBTIQ+ në Kosovë. Sfidat kryesore janë të lidhura me mungesën e të dhënave të strukturuar, mungesën e përgjigjes institucionale dhe vonesat në trajtimin e kërkesës, si dhe ndonjëherë shoqëruar me përgjigje homofobike dhe pasiv-agresive në dhjetëra shkëmbime telefonatash e emailsh rikujtuese, duke nxjerrë në pah nevojën për ndërtimin e bazës së parë për hulumtime të ardhshme. Ndër të tjera, këto përvoja reflektojnë mungesën e kapaciteteve për trajtimin e rasteve, si dhe mungesën e trajnimit për zyrtarët mbi nevojat dhe sfidat specifike të individëve nga komunitetet LGBTIQ.

Një nga sfidat përmbajtësore ka qenë mungesa e një baze të dhënash kombëtare për krimet e urrejtjes dhe dhunën me

bazë gjinore që përfshijnë individët LGBTIQ+. Mungesa e një sistemi të integruar për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor të viktimave, e vështirëson monitorimin e përhapjes së këtyre rasteve. Mungesa e një dokumentacioni të saktë dhe të standardizuar e pengon trajtimin serioz të dhunës dhe ndalon adresimin e saj përmes reformave të duhura institucionale dhe për pasojë, ky qerthull i vështirëson dhe inicitivat studimore.

Andaj, ky hulumtim mund të shërbejë si bazament për studime të tjera më të thelluara dhe gjithëpërfshirëse duke qendëruar eksperiencat e individëve LGBTIQ+. Duke marrë parasysh përvojat e tyre të shumta dhe të shumëfishta të dhunës, është thelbësore të ndërmerren studime që i pasqyrojnë këto përjetime në një formë më kritike. Hulumtime të tilla jo vetëm që do të shtojnë njohuritë mbi dhunën dhe diskriminimin, por gjithashtu do të ndihmojnë në zhvillimin e politikave publike që adresojnë në mënyrë të veçantë nevojat e komunitetit LGBTIQ+.

REKOMANDIMET

Për të ndërtuar një sistem më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e komuniteteve LGBTIQ+ nga krimet e urrejtjes dhe dhuna me bazë gjinore në Kosovë, është thelbësore një ndërhyrje kritike në nivel institucional dhe ligjor, duke u fokusuar në përmirësimin e strukturave ekzistuese dhe mbushjen e boshllëqeve të theksuara që kanë lënë komunitetet në pasiguri e të pambrojtura.

1

Përkufizimi dhe Dënimi i Krimeve të Urrejtjes

Sistemi ligjor në Kosovë aktualisht mbart mungesa në identifikimin dhe dënimin e qartë të krimeve të urrejtjes që bazohen në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke krijuar kështu një hendek të thellë përballë padrejtësive që i përjetojnë komunitetet LGBTIQ+. Për ta luftuar këtë mungesë, kërkohet që legjislacioni t'i përkufizojë qartë krimet e urrejtjes për këtë komunitet dhe t'i forcojë dënimet për këto krime. Gjithashtu, trajnimi i posaçëm për punonjësi/et e policisë, prokurorisë dhe sistemit gjyqësor për identifikimin dhe ndjekjen penale të këtyre rasteve do të kontribuonte në një qasje më të drejtë dhe më të informuar. Në mungesë të këtyre masave, pjesëtarët/e e komuniteteve LGBTIQ+ mbeten jashtë mbrojtjes efektive të ligjit dhe ndihen të pasigurt/a për të raportuar rastet e dhunës, që shpesh kalojnë të pandëshkuara.

2

Zgjerimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore në Kosovë është i ndërtuar mbi një kornizë heteronormative, duke mos përfaqësuar popullatën LGBTIQ+ të cilët përballen me dhunë brenda familjes ose në marrëdhënie të të njëjtit seks. Përfshirja eksplicite e komunitetit LGBTIQ+ si viktimat të mundshme në ligj dhe njohja e dhunës në marrëdhëniet intime brenda komuniteteve janë hapa të domosdoshëm për të siguruar që viktimat të mund të kenë akses në ndihmë ligjore, mbrojtje dhe shërbime të përshtatshme, duke ndihmuar në zvogëlimin e cenueshmërisë së tyre dhe mbështetjen në rastet e dhunës me bazë gjinore.

3

Krijimi i Strehimoreve dhe Shërbimeve Gjithëpërfshirëse

Mungesa e shërbimeve të mirëfillta për individët LGBTIQ+ në strehimoret për viktimat e dhunës e thëllon më tej marginalizimin e këtij komuniteti. Shumë nga strehimoret ekzistuese nuk janë të pajisura për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe të sigurt për individët LGBTIQ+, veçanërisht për njerëzit transgjjinorë, të cilët përjashtohen shpesh për shkak të identitetit të tyre. Ministria e Shëndetësisë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, dhe divizionet e Mirëqenies Sociale duhet të zhvillojë protokolle të qarta për strehimoret që garantojnë pranimin dhe kujdesin për viktimat LGBTIQ+, të trajtojë stafin e këtyre institucioneve mbi nevojat specifike të këtyre komuniteteve dhe të zgjerojë shërbimet psikologjike dhe mbështetëse. Mungesa e këtyre protokolleve krijon një mjedis diskriminues dhe kufizon rëndë mundësinë për rehabilitim dhe mirëqenie të viktimave.

4

Përmirësimi i Mbledhjes dhe Monitorimit të të Dhënave për Rastet e Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ)

Mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse për rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj komuniteteve LGBTIQ+ e kufizon ndjeshëm kapacitetin e institucioneve për të adresuar dhe përmirësuar mbrojtjen e këtij komuniteti. Një sistem i unifikuar për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave për dhunën ndaj individëve LGBTIQ+ do të ndihmonte në krijimin e politikave më të fokusuara dhe përgjegjësive institucionale. Kjo përfshin trajnimin e zyrtarëve/eve të zbatimit të ligjit, punonjës/eve socialë dhe aktorëve të tjerë për të mbledhur të dhëna të sakta dhe të përgjithshme mbi rastet, si dhe

krijimin e mekanizmave të raportimit publik që rrisin transparencën. Mungesa e një sistemi të tillë bën që shumë raste të mbeten të panjohura ose të trajtohen në mënyrë fragmentare dhe të pakoordinuar.

5 Krijimi i Strehimoreve dhe Shërbimeve Gjithëpërfshirëse

Pa reforma gjithëpërfshirëse, që përfshijnë përkufizimin e qartë të krimeve të urrejtjes, përfshirjen e komunitetit LGBTIQ+ në ligjin për dhunën në familje, krijimin e strehëzave të sigurta dhe përmirësimin e monitorimit të të dhënave, Kosova vazhdon të lejojë që komunitetet më vulnerabel të jenë të pambrojtura dhe të përballen me diskriminim të zgjatur. Këto boshllëqe jo vetëm që e pengojnë drejtësinë, por krijojnë një mjedis që nxit dhe riprodhon ciklin e dhunës dhe diskriminimit ndaj komuniteteve LGBTIQ+. Harmonizimi i hapave dhe veprimtarive ndërinstucionale e shoqërore janë të nevojshme për të garantuar mbrojtje reale dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.



Shtojcat

Përgjatë këtij procesi hulumtimi janë kontaktuar 42 entitete nga 5 Komuna të Kosovës ndër të cilat; Gjykata, Policia, Prokuroria, ZMNV, QMGF, Ministria e Drejtësisë, QPS, OJF, aktivistë/e, ekspertë ligjore e avokate.

Ndërsa disa nga institucionet janë përgjigjur pjesërisht, asnjë nga 5 QPS-të e kontaktuara nuk është përgjigjur. Dhe vlen për t'u përmendur që brenda një hapësire kohore të dy muajve përfaqësues nga ZMNV-ja e Prishtinës, përveç telefonatave janë kontaktuar 6 herë me emaile përkujtuuese dhe në fund nuk morëm asnjë përgjigje.

Ndërsa vlen për t'u përmendur se Komuna e Ferizaj ka qenë më korrektja në përgjegjshmërinë institucionale dhe gatishmërinë për t'u përgjigjur.

Nga të cilat janë kryer 26 (gjithsesi disa syresh janë përgjigjur me informacione të fragmentuara dhe pa shifra.)

Kategoria	Institucioni/Organizatat/ Entitetet e kryera
NGO dhe organizatat partnere	CSGD, Rrjeti i Grave, QKSGJ,
Intervista/Pyetësorë të thelluar	Edona Tolaj, Kristiani Rrasaj, QIPS, Ministria e Drejtësisë, Diva, Lend Mustafa
Policia	Policia e Prishtinës Policia e Ferizajt Policia e Prizrenit
Prokuroria	Prokuroria e Prishtinës Prokuroria e Ferizajt Prokuroria e Gjakovës
Gjykatat Themelore	Gjykata Themelore Prizren Gjykata Themelore Pejë Gjykata Themelore Gjakovë
Qendrat për strehim dhe mbrojtje	<p>Qendra për Sigurinë e Grave dhe Fëmijëve (QSGF) Prizren</p> <hr/> <p>Shtëpia e Sigurt Gjakovë</p> <hr/> <p>Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF) Prishtinë</p> <hr/> <p>Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Shtëpia Imë" Ferizaj</p> <hr/> <p>ZMNV Ferizaj</p> <hr/> <p>Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG) Pejë</p>

Referencat

Amnesty International. (2023, August 30). *Kosovo: From paper to practice – Kosovo must keep its commitments to domestic violence survivors.* <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

Center for Equality and Liberty (CEL). "Kërkojmë shkarkimin e Duda Balje nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione." CEL Kosovo, <https://cel-ks.org/press-release/kerkojme-shkarkimin-e-duda-balje-nga-komisioni-per-te-drejtat-e-njeriut-barazi-gjinore-viktimat-e-dhunes-seksuale-gjate-luftes-per-persona-te-pagjetur-dhe-peticione/>.

Center for Social Group Development (CSGD). *Annual Report on LGBTIQ+ Rights in Kosovo 2023.* <https://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2024/05/Annual-Report-2023-AN-A.pdf>.

Crenshaw, K. (1991). *Mapping the Margins: Intersectionality, Identity Politics, and Violence Against Women of Color.* *Stanford Law Review*, 43(6), 1241–1299.

Dukagjini. (2024, 1 nëntor). *Qeveria shtyn për vitin 2024 miratimin e Kodit Civil.* Marrë nga <https://www.dukagjini.com/qeveria-shtyne-per-vitin-2024-miratimin-e-kodit-civil/>

hooks, bell. *Feminist Theory: From Margin to Center.* Boston: South End Press, 1984.

Kuci, Liri. Kosovo 2.0. (2024). *Tetë vjet në dritëhije*. Kosovo 2.0. Retrieved from <https://kosovotwopointzero.com/en/eight-years-in-the-light-and-shadow/>

Reporting Diversity Network. (2024) *Media Report: Monitoring Hate Speech in the Balkans*. https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2024/06/Monitoring-Report-on-Hate-Speech_Regional.pdf.

Media Diversity Institute. (2022). *Measuring Racism, Hate Speech and Discrimination in the Western Balkans and Turkey*. Reporting Diversity Network 2.0. Retrieved from https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2022/08/MRHS_Regional.pdf

Ministria e Drejtësisë e Kosovës. "Projektligji i Kodit Civil." Ministria e Drejtësisë e Kosovës, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,94>.

Ministria e Drejtësisë e Kosovës. Projektligji i Kodit Civil, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5582524D-4557-43D6-A814-D541D7E8E037.pdf>.

